REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 96 **prot.** **Kamëz, më** 20.11 **.2025**

V E N D I M
Nr. 80 **.Datë** 20/11 **2025**
MBI

"NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR. 115 DATË 20.11.2024 MBI: "MIRATIMIN E MANUALIT TË PROCEDURAVE PËR RREGULLAT, MËNYRAT DHE AFATET E TRAJTIMIT TË INDIVIDËVE QË NDODHEN NË KUSHTE TË VËSHTIRA EKONOMIKE DHE NUK MUND TË PERBALLOJNË QIRANË PËR VITIN 2026"

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 20.11.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.75 Datë 14.11.2025 në mbështetje të Ligjit Nr 139 datë 17.12.2015 "Për Vetqeverisjen Vendore", Ligjit Nr 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile"; Ligji nr.22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar; Vendimit nr. 384, datë 12.6.2019 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore", VKM nr.362 datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies subvencionimit qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij"; VKM nr. 459 datë 03.09.2019 "Rregullat për administrimin e kërkesave të njësive qeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufruktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet NJQV dhe ministrisë përgjegjëse për strehim", **Këshilli Bashkiak Kamëz";**

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të manualit lidhur me proçedurat për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të individeve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi i Punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë lidhur me pranimin e kërkesave dhe administrimin e dokumentacionit të aplikantëve që kanë aplikuar për të përfituar nga programi "*Subvencionimi qirasë*", si dhe Drejtoria Emergjencave Civile dhe Strehimit.

Manuali për rregullat, mënyrat dhe afatet e trajtimit të individëve që ndodhen në kushte të vështira ekonomike dhe nuk mund të përballojnë qiranë në Bashkinë Kamëz paraqitet në ankesin bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas **konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.**

KRYETAR KËSHILLI
HYSEN KOLDASHI